



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
“CHARLES TELFORD ERICKSON”
Golem — Kavaje

shkollaemesmeagrobiznesgolem@yahoo.it

Tel.0682063499

Nr. 188 prot

Golem më 20, 05, 2026.

Lenda: **Njoftim per vend pune te lire.**

Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerezore

Drejtoria e Maredhenieve me Publikun

Agjencia Kombetare e Punesimit dhe Aftesive

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar, vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”, i ndryshuar, udhëzimit nr.4, dt.18.08.2025, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar. Ofruesi publik i AFP-se, Shkolla e Mesme Profesionale Charles Telford Erickson” Golem-Kavaje ju njofton krijimin e vendit te lire per pozicionin:

1 (Nje) Roje per Shkollen ne Kavaje me pozicion:Roje me kohe te plote.

1.Kriteret e pergjithshme dhe kriteret e posacme.

Aplikanti për personelin mbështetës në ofruesit e AFP-së duhet të përmbushë këto kriteret:

Kriteret të përgjithshme:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyren.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e veprave penale.

- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit.
- f) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Kritere të posaçme për personelin mbeshtetes në ofruesit e AFP-së:

- a) Të ketë nivelin arsimor baze.

2. Dokumentet e aplikimit.

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) Letërmotivimin për pozicionin;
- b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi.
- c) Kartën e identitetit
- d) Deftese per nivelin arsimor baze.
- e) Librezën e punës;
- f) Cdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV.
- h) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) Vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda dates. 01.06.2026

3. Vlerësimi i kandidatëve do behet referuar percaktimeve të udhëzimit nr.759, dt.30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", I ndryshuar

Drejtor

Matilda Canaku

